L I G J
Nr.7773, datë 13.12.1993

PËR NJË SHTESË NË LIGJIN NR.7527, DATË 11.12.1991 "PËR SHËRBIMIN USHTARAK NË FORCAT E ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË"

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozim të një deputeti,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Në ligjin nr.7527, datë 11.12.1991 "Për shërbimin ushtarak në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë", pas nenit 24/a shtohet neni 24/b me këtë përmbajtje:

- "Studentët që kanë mbaruar dhe do të mbarojnë shkollat e larta me shkëputje nga puna të sistemit 5-vjeçar deri më 1 shtator 1995 përjashtohen nga shërbimi i detyrueshëm ushtarak aktiv.

Studentët e sistemit 5-vjeçar, që kanë filluar studimet universitare në vitin 1991, mbas një kursi parauniversitar 1-vjeçar, dhe do të mbarojnë shkollat e larta me shkëputje nga puna deri më 1 shtator 1996, përjashtohen nga shërbimi i detyrueshëm ushtarak aktiv".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

Shpallur me dekretin nr.740, datë 24.12.1993 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha.